



KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		06/10/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-060/24-44110			

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas



PROCESVERBAL

I

DËGJIMEVE BUXHETORE

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, Drenas

Datë: 20.08.2025

Ora: 19:15

Dëgjimet buxhetore në **Sallën e Kuvendit Komunal** për **Drenas** u mbajtën më **19 gusht 2025**, ku morën pjesë përfaqësues nga fshatrat **Drenas I, II dhe III, Shtrubullojë, Gilobar, Vasilevë, Poklek i Ri dhe i Vjetër**. Në këtë dëgjim buxhetor, nga Komuna ishin të pranishëm:

Ramiz Lladrovci	Kryetar i Komunës
Arben Shala	Nënkryetar i Komunës
Muhamet Gjoka	Drejtor i Drejtorisë për Arsim,
Endrit Gllareva	Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Publike
Nexhmedin Gruda	Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, dhe UD i Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Kushtrim Bajraktari	ZKF-Zyrtar Kryesor Financiar
Bekim Dobra	Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun

Rendi i ditës

Dëgjimi Buxhetor filloi me këtë rend dite:

1. Prezantimi i projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028,
2. Pranim dhe shqyrtimi i kërkesave,
3. Çështje të ndryshme.

Hyrje

Prezantimi i projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028

Hapjen e dëgjimit buxhetor e bëri **Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, z. Bekim Dobra**. Në fjalën e tij hyrëse, ai theksoi rëndësinë e organizimit të dëgjimeve buxhetore si mekanizëm i transparencës dhe i përfshirjes së qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor. Po ashtu, ai prezantoi rregullat dhe procedurat që do të ndiqeshin gjatë zhvillimit të këtij dëgjimi.

Tutje, fjalën e mori **Kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci**, i cili përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi qytetarët për pjesëmarrjen aktive në këtë proces. Ai theksoi se dëgjimi ka për qëllim shpalosjen e projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028, si dhe mbledhjen e kërkesave e propozimeve nga qytetarët për projektet e nevojshme në komunitet.

Kërkesat

Pranim dhe shqyrtimi i kërkesave

Pas fjalës përshëndetëse të Kryetarit Lladrovci, fjalën e morën përfaqësuesit e fshatrave të këtyre lokaliteteve, të cilët parashtruan kërkesat e tyre.

Përfaqësuesit e fshatrave paraqitën kërkesat e tyre. Në total u parashtruan tri kërkesa kryesore: Ndriçim publik, Infrastrukturë rrugore, Ujësjellës dhe kanalizim.

Kërkesat u pranuan dhe u regjistruan, ndërsa u dhanë përgjigje të përgjithshme nga kryetari i komunës dhe drejtorët përkatës.

Tabela e kërkesave dhe përgjigjeve

Përfaqësues / Banor	Lokaliteti	Kërkesa	Përgjigja / Sqarimi nga institucioni
Habib Tahiraj	Drenas I	Riparimi i urës në rrugën për në fshatin Shtrubullovë; pastrimi i kanalizimit përreth sheshit për shkak të erërave të këqija; lirimi i trotuareve; shtrimi me kocka i trotuarit në rrugën nën hekurudhë deri te xhamia.	Komuna është në dijeni për këto çështje dhe ka paraparë ndërhyrje në kuadër të mirëmbajtjes së infrastrukturës lokale. Riparimi i urës në rrugën për në Shtrubullovë, jemi në pritje të rregullimit të shtratit të lumit përreth asaj ure, dhe kjo është nën kompetencë të Ministrisë. Pastrimi i kanalizimit përreth sheshit për eliminimin e erërave të këqija, lirimi i trotuareve dhe shtrimi me kocka i trotuarit nga rruga nën hekurudhë deri te xhamia janë pjesë e planit të punimeve që do të realizohen brenda afatit të përcaktuar. Ekipet përkatëse janë njoftuar dhe do të veprojnë sipas prioritetit dhe nevojës në terren.
Murat Elshani	Gllobar	Kërkesa: Lidhja e rrugës Tahir Krasniqi me rrugën Izet Elshani, për shkak të qarkullimit të madh të automjeteve deri te pishat.	Kryetari: Kemi plan ta shtrijmë rrugën nga stadiumi me bari sintetik deri te pishat, që do të lehtësonte qarkullimin edhe për fshatin Gllobar.
Besian Murtezi	Shtrubullovë	Asfaltimi i disa lagjeve. Ndriçim publik, pasi disa rrugica kanë mbetur pa funksionim të ndriçimit.	Të gjitha ato që i permende tashme janë ne proces e sipër dhe brenda një periudhe shume të shkurtet do të finalizohen.
Zekë Kluna	Poklek i Ri, Poklek i Vjetër dhe Vasilevë	Në Vasilevë ka mbetur një rrugë pa asfaltuar. Në Poklek të Ri mungon ndriçimi. Në Poklek të Vjetër, në lagjen Bucolli	Faleminderit për vërejtjet dhe kërkesat e paraqitura. Komuna është në dijeni për këto çështje dhe ato

		munjon kanalizimi. Gropa septike ende nuk është sanuar dhe gjendet sipër ujit të gazuar.	tashmë janë përfshirë në planin e punimeve të radhës. Asfaltimi i rrugës në Vasilevë, vendosja e ndriçimit publik në Poklek të Ri dhe ndërtimi i kanalizimit në lagjen Bucolli të Poklekut të Vjetër do të trajtohen në fazat e ardhshme të investimeve. Sa i përket gropës septike, ekipi përkatës do të dalë në terren për sanimin e menjëhershëm dhe për të garantuar siguri mjedisore.
Shpend Shala	Banor në Drenas	Parking për banorët rezident. Shkolla “Rasim Kiçina” – a ka kriteret për pranimin e nxënësve të rinj? Ka raste që fëmijët vijnë nga lokalitete të tjera, duke krijuar mbingarkesë në klasa. Gjithashtu, a mund të ndërtohen tualete jashtë objektit për shkak të mirëmbajtjes më të lehtë? Sqarim për furnizimin me ujë të pijshëm, pasi ka thashetheme për problemet.	Problemi i parkingjeve është i madh. Kërkesat janë të shumta dhe duhet vendosur nëse do të jenë me pagesë apo pa pagesë. Për momentin ka edhe keqpërdorim nga vetë banorët. Muhamet Gjoka, Drejtor i Arsimit: Zhvendosja e tualeteve jashtë objektit të shkollës është e pamundur. Furnizimi me ujë të pijshëm është detyrë dhe obligim i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “KRU Prishtina”. Fatkeqësisht kjo kompani shpesh nuk i kryen detyrimet ndaj qytetarëve dhe shumë lokalitete mbesin pa ujë. Ndërkohë, komuna i ka përmbushur të gjitha obligimet e saj ndaj qytetarëve për këtë çështje.

Çështje të ndryshme

Nuk pati pika shtesë për diskutim.


Përfundimi

Meqenëse rendi i ditës u përmyll, dëgjimi buxhetor u shpall i përfunduar.

Kryetari falënderoi pjesëmarrësit për kontributin e tyre.

Numri i Pjesëmarrësve		
M - 13	F - 2	Totali: 17

Procesmbajtësi


Arton Hasani

